



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Maj 2022

Nr: 161

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË LUSHNJË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALDEMOKRATE
TË SHQIPËRISË, ZJ. VOJSAVA KLEMENT BUSHI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 9189 prot., datë 26.11.2021, këshilli i bashkisë Lushnjë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Enkelejda Rrapi Puka, propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Lushnjë të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 09, zj. Vojsava Klement Bushi.

Me shkresën nr.1858, prot., datë 23.03.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatis për anëtar në këshillin e bashkisë Lushnjë, zj. Vojsava Klement Bushi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Data: 19 Maj 2022

Nr. 161

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Lushnjë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë zj. Vojsava Klement Bushi

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 25 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, zj. Vojsava Klement Bushi, në këshillin e bashkisë Lushnjë, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 2036 prot., datë 05.04.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2035 prot., datë 05.04.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, zj. Vojsava Klement Bushi, në këshillin e bashkisë Lushnjë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 3427/1 prot., datë 19.04.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Vojsava Klement Bushi, në këshillin e bashkisë Lushnjë, e cila rezulton se ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, në rubrikën e emrit nga “Vjola” në “Vojsava”.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 4054/1 prot., datë 08.04.2022 dhe shkresën nr. 4974/1 prot., datë 29.04.2022 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Vojsava Klement Bushi, në këshillin e bashkisë Lushnjë, e cila rezulton se nuk ka të rregjistruar dënim penal të formës së prerë, është e padënuar.

Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Vojsava Klement Bushi në këshillin e bashkisë Lushnjë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave



të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

V E N D O S:

1. Zj. Vojsava Klement Bushi, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Lushnjë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Lushnjë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, zj. Vojsava Klement Bushi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

